



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004/28

PËR PUNIMET NGA METALET E ÇMUARA

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullorës Nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, sipas Kreut 5.1(d), 9.1.1, 9.3.3, 11.2, dhe në bazë të Rregullores nr.1999/1 dt.25 qershor 1999 për Autoritetin e Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë, të plotësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/ 24 të dt. 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë dhe,

me qëllim të mbrojtjes së tregut të Kosovës nga prodhimi, importimi dhe shitja e punimeve prej metaleve të çmueshme që nuk plotësojnë standardet të caktuara me këtë ligj dhe nga konkurenca jolojale e tregut të lirë në Kosovë, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN PËR PUNIMET NGA METALET E ÇMUARA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Me këtë ligj rregullohet përshtatja e prodhimit dhe e shitjes së punimeve nga metalet e çmuara me Standardet Ndërkombtare ISO 9202 (International Standard ISO 9202 Jewellery-Fineness of metal alloys) sa i përket përbërjes dhe përmbajtjes (pastërtisë) së punimeve nga metalet e çmuara;

1.2. Sigurohen të drejtat dhe detyrat e prodhuesve dhe të importuesve të punimeve nga metalet e çmuara;

1.3. Rregullohet mënyra e kontrollimit, hulumtimit dhe vulosjes së punimeve nga metalet e çmuara.

1.4. Të drejtat dhe detyrat në këtë lëmi realizohen përmes Institutit të Metrologjisë Legale të Kosovës, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë zbaton këtë ligj.

1.5. Me zbatimin e përpiktë të këtij ligji, realizohet:

- a. kontrollimi dhe shenjimi i të gjitha punimeve nga metalet e çmuara që vehen në qarkullim publik;
- b. mbrojtja e prodhuesëve dhe e blerësve të punimeve nga metalet e çmuara prej keqpërdorimeve të mundshme;

Neni 2

Punimet nga metalet e çmuara mund të vehen në qarkullim publik vetëm nëse ato me përbërjen dhe përmbajtjen e vet i plotësojnë kushtet e parashikuara me këtë ligj.

Definicionet dhe rregullat e interpretimit

Neni 3

Cilido prej termeve në vijim, kurdo që të përdoret në këtë ligj, kanë kuptimin e dhënë, përveç nëse konteksti brenda të cilit një term i tillë paraqitet, nënkupton qartë diçka tjetër:

Ministër nënkupton Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ministri nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e themeluar në pajtim me Rregulloren nr. 2001/19 të UNMIK-ut.

Instituti i Metrologjisë Legale i Kosovës (IMLK) nënkupton institucionin i cili zbaton ligjin në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Metalet e çmuara në vështrim të këtij ligji nënkuptojnë: platinën, arin, argjentin, iridiumin dhe paladiumin.

Punimet nga metalet e çmuara, në vështrim të këtij ligji nënkuptojnë: stolitë, zburimet dhe punimet tjera të punuara prej platinës, arit, argjentit, përkatësisht prej legurave të këtyre metaleve.

Prodhues është personi fizik apo juridik i cili bën prodhimin e punimeve prej metaleve të çmuara.

Shitës është personi fizik apo juridik që shet punimet prej metaleve të çmuara.

Strukturat publike kontrolluese të tregut –nënkuptojnë organet inspektuese të tregut, të cilët mbikqyrin tregun në bazë të kompetencave të dala nga ligjet në fuqi, lidhur me kontrollimin e punimeve prej metaleve të çmuara të vëna në qarkullim.

Importues –është personi fizik apo juridik i cili importon punime prej metaleve të çmuara në pajtim me ligjin.

Neni 4

Punimet nga metalet e çmuara para se të vehen në qarkullim publik, i nënshtrohen ekzaminimit dhe vulosjes të detyrueshëm sipas dispozitave të këtij ligji.

II. PËRBËRJA DHE PËRMBAJTJA E PUNIMEVE NGA METALET E ÇMUARA

Neni 5

Punimet nga metalet e çmuara mund të prodhohen nëse:

- a. punimet e arit janë prodhuar prej legurës, përbërja e së cilës është përzierja e:
 - i arit me argjent
 - ii arit me bakër
 - iii arit me argjent dhe bakër
 - iv arit me nikël dhe paladium,
- b. punimet e argjentit janë prodhuar prej legurës, përbërja e së cilës është
 - i përzierja e:
 - ii argjentit me bakër.
- c. punimet e platinës janë prodhuar prej legurës, përbërja e së cilës është
 - i përzierja e:
 - ii platinës me argjent dhe bakër.

Neni 6

- 6.1. Legurave të përmendura në nenin 5, mund ti shtohen edhe metale tjera.
- 6.2. Prodhuesi i punimeve nga metalet e çmuara ka për detyrë, që me rastin e paraqitjes së punimeve për ekzaminim dhe vulosje, të theksojë në formularin e fletëdorëzimit llojin, përbërjen si dhe përmbajtjen metaleve që bëjnë pjesë në legurën e metalit të çmuar.
- 6.3. Iridiumi që gjendet në legurën e punimeve prej platinës, konsiderohet si platinë.
- 6.4. Punimet prej argjentit, të cilat janë të praruara me ari, konsiderohen si punime prej argjenti.

Neni 7

- 7.1. Pastërtia e arit, e argjendit dhe e platinës, të punimet e punuara prej legurës së këtyre metaleve, paraqet pjesëmarrjen e masës së metalit të çmuar (m_1) ndaj masës së tërësishme (m_2) të atij punimi, e shprehur me të miltat pjesë $p = (m_1 / m_2) \cdot 1000$;
- 7.2. Punimet nga metalet e çmuara duhet të kenë vetëm një të njërën nga këto shkallë të pastërtisë:

- a. punimet prej ari:
 - i. shkalla e I: 999 të miltat (999/1000)
 - ii. shkalla e II: 916 të miltat (916/1000)
 - iii. shkalla e III: 750 të miltat (750/1000)
 - iv. shkalla e IV: 585 të miltat (585/1000)
 - v. shkalla e V: 375 të miltat (375/1000)

b. punimet prej argjendi:

- i. shkalla e I: 999 të mijt (999/1000)
- ii. shkalla e II: 925 të mijt (925/1000)
- iii. shkalla e III: 830 të mijt (830/1000)
- iv. shkalla e IV: 800 të mijt (800/1000)

c. punimet prej platinës:

- i. shkalla e I: 999 të mijt (999/1000)
- ii. shkalla e II: 950 të mijt (950/1000)
- iii. shkalla e III: 900 të mijt (900/1000)
- iv. shkalla e IV: 850 të mijt (850/1000)

7.3. Përjashtim nga dispozitat e mëparshme bëjnë punimet nga metalet e çmuara, të punuara me farkëtim (monedha ari, monedha argjendi, pllaka përkujtimore e të ngjashme), që mund të kenë këto shkallë të pastërtisë:

- a. punimet nga ari 900 të mijt (900/1000),
- b. punimet nga argjendi 925 të mijt (925/1000).

Neni 8

Punimet prej arit ose prej argjentit, pastërtia e të cilave është më madhe nga pastërtia e parashikuar për shkallën e caktuar sipas nenit 7, ndërsa më e vogël nga shkalla pasuese më e lartë, trajtohen si punime me pastërti të shkallës së ultë. .

III. SHENJIMI E PUNIMEVE NGA METALET E ÇMUARA

Neni 9

9.1. Prodhuesi ka për detyrë që në punimet e prodhuara nga metalet e çmuara t'i shenjoj me shenjën e vet (shenjën identifikuese) dhe shenjën e pastërtisë.

9.2. Importuesi ka për detyrë që në punimet prej metaleve të çmuara, të importuara, t'i vënë shenjën e vetë identifikuese. Ndërsa shenjën e pastërtisë duhet vënë vetëm në rast se shenja ekzistuese e pastërtisë nuk i përgjigjet kushteve të caktuara me nenin 7.

9.3. Punimet që kanë masën nën 1 gram, nuk shenjohen me shenjën identifikuese e as me shenjën e pastërtisë, por pas ekzaminimit të punimeve, nëse ato i plotësojnë kushtet nga neni 7, vulosen vetëm me vulën e IMLK-së.

Neni 10

10.1. Shenja identifikuese i jipet prodhuesit ose importuesit, me kërkesën e tij. Instituti i Metrologjisë Legale i Kosovës në bazë të Rregullores mbi caktimin e dukjes, madhësisë dhe mënyrës së përdorimit të shenjës identifikuese për punimet prej metaleve të çmuara bjen vendim me të cilin cakton përmbajtjen, formën, dimensionet dhe mënyrën e përdorimit të shenjës identifikuese.

10.2. Madhësitë e zakonshme të shenjave të identifikimit janë:

Platini: jo më i vogël se 0.75 mm

Ari: 1.5 mm
1.0 mm
0.75 mm
0.5 mm

Argjendi: 4.0 mm
2.0 mm
1.5 mm
1.0 mm
0.75 mm

10.3.. Prodhuesi ose importuesi, punimet e veta nuk mund t'i shenjojë me shenja tjera identifikuese pos shenjës identifikuese të lëshuar me vendim.

10.4.. Matricat e shenjave identifikuese dhe gjurmat e shenjave identifikuese në pllakën e aluminit, ruhen në IMLK.

Neni 11

Instituti i Metrologjisë Legale i Kosovës do të ç'fuqizojë Vendimin mbi shenjën identifikuese në rastet kur:

- a. konstaton se prodhuesi ose importuesi më nuk i plotëson kushtet e parapara me aktin nënligjor për dhënjen e Vendimit për shenjën identifikuese;
- b. konstaton se prodhuesi ose importuesi ka bërë falsifikimin e shenjave për shenjimin e punimeve nga metalet e çmuara;
- c. prodhuesi ose importuesi ndërprejë veprimtarinë e vet.

Neni 12

Prodhuesi dhe importuesi, me rastin e ç'regjistrimit të veprimtarisë, ka për detyrë që për këtë të lajmëron IMLK-në.

IV. EKZAMINIMI DHE SHENJIMI I PUNIMEVE NGA METALET E ÇMUARA

Neni 13

13.1. Punimet nga metalet e çmuara, para se të vëhen në qarkullim publik i nënshtrohen ekzaminimit të detyrueshëm në pikëpamje të përbërjes dhe përmbajtjes (pastërtisë).

13.2. Punimet të cilat në pikëpamje të përbërjes, përmbajtjes dhe shenjave i plotësojnë kushtet e parashikuara me nenet 5, 6, 7, dhe 9 do të vulosen me vulën e IMLK-së.

Neni 14

Ekzaminimit dhe shenjimit të detyrueshëm nuk u nënshtrohen:

- a. aparatet dhe instrumentet, të cilat shërbejnë për qëllime kërkimore, aparatet dhe instrumentet që shërbejnë për qëllime shëndetësore, mjetet për prodhim dhe mjetet për ekzaminime laboratorike,
- b. punimet nga metalet e çmuara të prodhimit më të hershëm, të cilat kanë vlerë shkencore, artistike, historike ose kulturore,
- c. pendat për stilografë.

Neni 15

Punimet nga metalet e çmuara të cilat janë të destinuar për eksport, nuk i nënshtrohen ekzaminimit dhe vulosjes nëse eksportuesi paraqet dëshmi se importuesi i huaj kërkon që këto punime të mos vulosen ose të kenë përbërje dhe përmbajtje tjetër nga ajo që është parashikuar me këtë ligj.

Neni 16

16.1. Punimet nga metalet e çmuara në pronësi individuale nuk i nënshtrohen ekzaminimit dhe vulosjes së detyrueshme.

16.2. Punimet nga metalet e çmuara në pronësi individuale i nënshtrohen ekzaminimit dhe vulosjes së detyrueshme nëse poseduesi i tyre i ven ato në shitje.

16.3. IMLK ka për detyrë që me kërkesën e poseduesit të punimeve nga metalet e çmuara të bën ekzaminimin dhe vulosjen e këtyre punimeve edhe nëse poseduesi nuk i ven ato në shitje.

16.4. Nëse me rastin e ekzaminimit të punimeve nga metalet e çmuara në pronësi individuale, vërtetohet se ato në pikëpamje të pastërtisë nuk kanë as shkallën më të ultë të pastërtisë të përcaktuar me ligj, punimet e tilla do ti kthehen poseduesit të pavulosura.

Neni 17

Punimet nga metalet e çmuara, pas vulosjes nga ana e IMLK-së, nuk mund të ripërpunohen e as të bëhet ndryshim në to. Në të kundërtën punimet e tilla duhet përsëri ti nënshtrohen ekzaminimit.

Neni 18

18.1. Prodhuesi i punimeve nga metalet e çmuara, me rastin e dorëzimit të punimeve në IMLK për ekzaminim dhe vulosje, ka për detyrë të plotëson formularin me të dhëna mbi llojin e punimeve, numrin e tyre, masën, përbërjen e legurës, dhe përmbajtjen e legurës.

18.2. Importuesi i metaleve të çmuara ka për detyrë që me rastin e dorëzimit të punimeve në IMLK për ekzaminim dhe vulosje, të dorëzon deklaratën e doganës.

Neni 19

Me anë të ekzaminimit dhe vulosjes të punimeve nga metalet e çmuara bëhet vërtetimi i pastërtisë (përmbajtjes), i përbërjes së legurës të punimit nga metalet e çmuara.

Neni 20

20.1. Ekzaminimi dhe vulosja e punimeve nga metalet e çmuara bëhet në laboratorin e IMLK-së.

20.2. Ekzaminimi dhe vulosja e punimeve nga metalet e çmuara bëhet edhe në laboratorin e prodhuesit ose të importuesit, nëse ky laborator është i autorizuar nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë përmes IMLK-së.

Neni 21

21.1. Ndalohet bartja e pjesës së vulosur nga një punim në punimin tjetër.

21.2. Pas vulosjes të një punimi nga metali i çmuar, atij nuk mund t'i shtohet më asnjë pjesë tjetër.

Neni 22

22.1. Shpenzimet e ekzaminimit dhe vulosjes së punimeve nga metalet e çmuara i paguan parashtruesi i kërkesës: prodhuesi, importuesi ose poseduesi i këtyre punimeve nga metalet e çmuara.

22.2. Të ardhurat nga veprimtaria e ekzaminimit dhe vulosjes së punimeve nga metalet e çmuara derdhen në Buxhetin e Kosovës përmes xhirollogarisë së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

V. VËNJA NË QARKULLIM (SHITË-BLERJA) TË PUNIMEVE NGA METALET E ÇMUARA

Neni 23

Punimet nga metalet e çmuara mund të vihen në vendet e shitjes vetëm pasi të jenë të vulosura nga ana e IMLK-së.

Neni 24

Punimet prej metaleve të çmuara që janë të ekspozuara për shitje duhet të jenë të ndara prej punimeve që nuk janë punime prej metaleve të çmueshme-bizhuteri.

Neni 25

Personat fizikë dhe juridikë që mirren me shitjen e punimeve nga metalet e çmuara duhet të kenë fotografinë e vulave zyrtare të IMLK-së në vend të dukshëm dhe thjerrzën zmadhuese me të cilën mund të dallohen vulat në punimet prej metaleve të çmuara.

VI. MBIKQYRJA DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 26

Mbikqyrjen mbi rregullsinë e shitjes të punimeve nga metalet e çmuara e bën inspekcioni i tregut.

Neni 27

27.1. Inspektori i tregut, si organ mbikqyrës për kryrjen e punëve nga ky Ligj ndërmerr masa të lejuara në bazë të këtij ligji dhe akte të përcaktuara me ligjin e Tregtisë së Brendshme dhe Ligjin e Inspekcionit Tregtar.

27.2. Nëse inspektori i tregut vërteton që punimet nga metalet e çmuara, që janë në çarkullim nuk janë të shenjuara sipas dispozitave të këtij ligji, bjen vendimin me të cilin ndalohet shitja e punimeve dhe një kopje të këtij vendimi ia dorëzon organit mbikqyrës.

27.3. Punimet nga metalet e çmuara, për të cilat është sjellë vendimi nga paragrafi 2 të këtij neni menjëherë tërhiqen nga çarkullimi. Këto punime duhet të paketohen dhe paketa të pllombohet nga ana e inspektorit.

27.4. Pronari i punimeve nga metalet e çmuara obligohet që brenda 15 ditësh, paketën e pllombuar nga inspektori i tregut bashkë me procesverbalin të dorëzon për ekzaminim dhe vulosje në IMLK.

27.5. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 2 e këtij neni nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 28

Ekspertizën e përmbajtjes, përbërjes, shenjave dhe vulës së punimeve nga metalet e çmuara e kryen IMLK.

VII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 29

Me gjobë prej 1000 € deri 5000 € dënohet për delikt ekonomik ndërmarrja:

- a. nëse punimet prej metaleve të çmuara para se të vihen në qarkullim nuk i nënshtrohen vulosjes së detyrueshme (neni 4);
- b. nëse konstaton se prodhuesi ka vënë në qarkullim punimet nga metalet e çmuara duke bërë falsifikimin e shenjave me të cilin është bërë shenjimi i punimeve (neni 10 paragrafi 2);
- c. nëse bëhet bartja e pjesës së shenjuar nga një punim në një punim tjetër nga metali i çmuar (neni 21 paragrafi 1);
- d. nëse organin mbikqyrës nuk e lejon apo e pengon në mbikqyrjen të punimeve prej metaleve të çmuara (neni 26).

Neni 30

Me gjobë prej 200 € deri 1000 € do të dënohet për delikt për kundërvajtje ndërmarrja nëse:

- a. nuk i ve në vend të dukshëm fotografinë e shenjave zyrtare për vërtetimin e pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara si dhe thjerrzën zmadhuese për kontrollimin e dukjes së vulave në punime (neni 25).

Neni 31

Me gjobë prej 100 € deri 500 € dënohet për kundërvajtje personi fizik:

- a. nëse punimet prej metaleve të çmuara para se të vihen në qarkullim nuk i nënshtrohen vulosjes së detyrueshme (neni 4);
- b. nëse konstaton se prodhuesi ka vënë në qarkullim punimet nga metalet e çmuara duke bërë falsifikimin e shenjave me të cilin është bërë shenjimi i punimeve (neni 10 paragrafi 2);
- c. nëse bëhet bartja e pjesës së shenjuar nga një punim në një punim tjetër nga metali i çmuar (neni 21 paragrafi 1);
- d. nëse organin mbikqyrës nuk e lejon apo e pengon në mbikqyrjen të punimeve prej metaleve të çmuara(neni 26).

Neni 32

Me gjobë prej 50 € deri 150 € do të dënohet për kundërvajtje personi fizik nëse nuk i ve në vend të dukshëm fotografinë e **vulave** zyrtare për vërtetimin e pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara si dhe thjerrzën smadhuese për kontrollimin e dukjes së **vulave** në punime (neni 25).

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 33

33.1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji ç'fuçizohen të gjitha aktet tjera nënligjore që rregullojnë kontrollimin e punimeve nga metalet e çmuara.

33.2. Aktet nënligjore të këtij ligji i bjen MTI në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga PSSP-ja.

Ligji Nr.2004/28
28 korrik 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci